



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 maj 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i

Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 21(6) dhe 39(11) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 95(4)(b) dhe (c), dhe 102(1)(b) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcaktoi, ndër të tjera, kalendarin për nxjerrjen e provave, duke përfshirë afatin për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, konkretisht datën 30 korrik 2021.⁴
3. Më 17 dhjetor 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi dosjen paraprake dhe materialet përkatëse të saj, ndër të cilat Lista e Dëshmitarëve (“Lista e Dëshmitarëve”) dhe Lista e Provave Materiale (“Lista e Provave Materiale”).⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u nxorën më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionin e Mbrojtjes për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar, më 1 nëntor 2021, u dorëzua një aktakuzë e korrigjuar, F00098/A01, konfidenciale, dhe më 16 nëntor 2021 u dorëzua versioni publik i saj, F00107/A01.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00033, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të Lidhura me To*, 30 prill 2021, publik, para.45.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00135, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake, me Listat e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, 28 janar 2022, publik, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara konfidenciale të dosjes paraprake, listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale u dorëzuan më 31 janar 2022, F00136. Versionet konfidenciale me më pak redaktime të dosjes paraprake dhe listës së dëshmitarëve u dorëzuan më 8 shkurt 2022, F00139.

4. Më 25 mars 2022, ZPS-ja kërkoi leje për nxjerrjen e transkripteve të intervistave të saj me W04276-ën, W04880-on, W04881-shin dhe W04882-shin (“dëshmitarët”), pas mbarimit të afatit të vendosur nga rregulla 102(1)(b) e Rregullores, dhe, rrjedhimisht, për ndryshimin e Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale të saj (“Kërkesa”).⁶

5. Më 6 prill 2022, Mbrojtja e Pjetër Shalës (“i akuzuari” dhe “Mbrojtja”) iu përgjigj kërkesës (“Përgjigjja”).⁷

6. Më 11 prill 2022, ZPS-ja iu kundërpërgjigj përgjigjes (“Kundërpërgjigjja”).⁸

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja parashtron se transkriptet e intervistave të saj me dëshmitarët nuk ishin nxjerrë brenda afatit të vendosur nga rregulla 102(1)(b) e Rregullores, sepse nevoja hetimore për intervistimin e dëshmitarëve lindi pas mbarimit të atij afati, konkretisht, [REDAKTUAR].⁹ ZPS-ja shton se, pas [REDAKTUAR], ajo kishte arritur në përfundimin se [REDAKTUAR] mund të ndihmonte procesin hetimor.¹⁰ Sipas ZPS-së, pas gjetjes së vendndodhjes së tyre, ajo dorëzoi një kërkesë për ndihme juridike ndërkombëtare pranë autoriteteve kombëtare kompetente dhe zhvilloi intervista me W04880-ën, W04881-shin dhe W04276-ën [REDAKTUAR], dhe me W04882-shin

⁶ KSC-BC-2020-04, F00169, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe për Ndryshimin e Listave të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale të Saj*, 25 mars 2022, konfidenciale, para. 1-2, 6, 9, 11, 13. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 mars 2022, F00169/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00175, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje ndaj “Kërkesës së Prokurorisë sipas Rregullës 102(2) dhe për Ndryshimin e Listave të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale të Saj”*, 6 prill 2022, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00180, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Mbrojtjes sipas Rregullës 102(2) dhe për Ndryshimin e Listave të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale të Saj*, 11 prill 2022, konfidenciale. Në kundërpërgjigje, ZPS-ja, ndër të tjera, sqaron se referencat për W04480-on dhe W04481-shin në Kërkesë janë të pasakta dhe se numrat e saktë të këtyre dëshmitarëve janë W04880 dhe W04881.

⁹ Kërkesa, para. 1, 7.

¹⁰ Kërkesa, para. 3, 7.

[REDAKTUAR].¹¹ ZPS-ja vë gjithashtu në dukje se nuk do të kërkojë masa mbrojtëse për asnjë nga dëshmitarët.¹²

8. Mbrojtja e kundërshton Kërkesën pasi ZPS-ja nuk ka paraqitur arsye të vlefshme për intervistimin e dëshmitarëve në një fazë kaq të vonshme të procesit, duke pasur parasysh dhe faktin se miratimi i kërkesës do të cenonte Mbrojtjen.¹³ Sipas Mbrojtjes, [REDAKTUAR] ka qenë e njohur për ZPS-në të paktën që nga viti 2018 dhe, gjithsesi, për një periudhë të konsiderueshme kohe para [REDAKTUAR] 2021, dhe [REDAKTUAR] procesit gjyqësor të kryer 20 vjet pas ngjarjeve të përshkruara në Aktakuzën e Konfirmuar, pra nuk është një ngjarje e paparashikuar.¹⁴ Mbrojtja shton se përfshirja e propozuar në momentet e fundit e materialeve në Listën e Dëshmitarëve dhe në Listën e Provave Materiale cenon Mbrojtjen sepse ajo nuk ka kohë të mjaftueshme për përgatitjen e provave të saj.¹⁵ Si alternativë, Mbrojtja thekson se, nëse Kërkesa miratohet, asaj do t'i duhet kohë shtesë dhe, gjithsesi, e mjaftueshme për t'u njohur me provat e ZPS-së.¹⁶

9. ZPS-ja kundërpërgjigjet se nuk ka pasur as njohuri e as të dhëna se [REDAKTUAR].¹⁷ Sipas mendimit të saj, pretendimi i Mbrojtjes bazohet në shpjegimin [REDAKTUAR] për pasojat [REDAKTUAR] rrahjet që kishte pësuar gjatë qëndrimit në paraburgim, por nuk kishte asnjë të dhënë se [REDAKTUAR].¹⁸ ZPS-ja parashton gjithashtu se pretendimi i Mbrojtjes se ZPS-ja po përpiket të ndryshojë provat e saj është po aq i pasaktë, pasi dëshmitarët ofrojnë kryesisht konfirmime [REDAKTUAR].¹⁹

¹¹ Kërkesa, para. 5, 7, 9.

¹² Kërkesa, para. 10.

¹³ Përgjigjja, para. 2-4, 7.

¹⁴ Përgjigjja, para. 5.

¹⁵ Përgjigjja, para. 6.

¹⁶ Përgjigjja, para. 8.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 3.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 3.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 4.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas Nenit 21(6) të Ligjit, i gjithë materiali dhe provat ose faktet relevante në zotërim të ZPS-së, të cilat janë në favor ose kundër të akuzuarit, i vihen në dispozicion atij ose asaj para fillimit të procesit dhe gjatë tij, dhe u nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që janë rreptësisht të nevojshme dhe atëherë kur zbatohen garancitë mbrojtëse kompensuese të nevojshme.

11. Sipas rregullës 95(4)(b) dhe (c) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Prokurorin e Specializuar që brenda një afati të përcaktuar, të paraqesë listën e dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon të thërrasë dhe listën e provave materiale të propozuara që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë.

12. Sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe jo më vonë se 30 ditë përpara hapjes së çështjes nga Prokurori i Specializuar, ZPS-ja i vë në dispozicion Mbrojtjes materialet e mëposhtme: (i) deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjykim, në një gjuhë të cilën i akuzuari e kupton dhe e flet; (ii) të gjitha deklaratat e tjera të dëshmitarëve, aktekspertizat, deponimet apo transkriptet që Prokurori i Specializuar synon t'i paraqesë në gjykim; dhe (iii) provat materiale që ZPS-ja synon t'i paraqesë në gjykim.

13. Sipas rregullës 102(2) të Rregullores, deklaratat e dëshmitarëve shtesë të ZPS-së, të cilat nuk i janë bërë të njohura Mbrojtjes brenda afatit të përcaktuar prej trupit gjykues dhe të cilët ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar në gjyq, i bëhen të njohura Mbrojtjes sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me arsyet për nxjerrjen e vonuar të materialeve.

IV. DISKUTIM

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fillimisht vë në dukje se rregulla 118 e Rregullores autorizon trupin gjykues që gjatë përgatitjes për gjykim, pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, të lejojë ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe të provave materiale të paraqitura sipas rregullës 95(4)(b) të Rregullores.

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë gjithashtu në dukje se, në fazën paraprake, Rregullorja nuk parashikon shprehimisht një ndryshim të tillë. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ai mund të marrë vendim mbi një kërkesë për ndryshim të Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale në fazën paraprake, duke pasur parasysh që rregulla 118 e Rregullores e lejon një mundësi të tillë në një fazë të mëvonshme të procesit. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ai ka kompetencë për të marrë vendim në lidhje me Kërkesën në përputhje me rregullën 95(2)(b) të Rregullores, duke qenë se ajo në fund ka të bëjë me nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores dhe me mënyrën se si kjo nxjerrje materiale është paraqitur përmes Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të vlerësojë nëse ZPS-ja ka paraqitur arsye të vlefshme për ndryshimet e kërkuara.²⁰

16. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të Kërkesës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se: (i) ZPS-ja ka bërë të ditur synimin e saj për të ndërmarrë veprime hetimore shtesë [REDAKTUAR], për të cilat Mbrojtja ka dijeni;²¹ (ii) u desh të gjendej vendndodhja e dëshmitarëve dhe të kërkohej ndihmë juridike ndërkombëtare;²² (iii) ZPS-ja intervistoi dëshmitarët [REDAKTUAR] dhe dorëzoi Kërkesën [REDAKTUAR],²³ dhe (iv) hetimet e Mbrojtjes janë duke vijuar dhe dosja e çështjes

²⁰ *Shih gjithashtu KSC-2020-05, F00156/RED, Trupi Gjykues I, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Listës së Dëshmitarëve dhe Pika të Tjera që Lidhen me Të, 16 korrik 2021, publik, para. 16-18.*

²¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, konfidencial, f. 177, rreshtat 13-20.

²² Kërkesa, para. 3, 4, 7.

²³ Kërkesa, para. 5, 7, 9.

gjqësore ende nuk i është kaluar Trupit Gjykues.²⁴ Në këto rrethana, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është dorëzuar në kohë.

17. Veç kësaj, ZPS-ja ka paraqitur arsye të vlefshme për nxjerrjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe ndryshimin e Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale. Arsyeja është [REDAKTUAR], ZPS-së pas kësaj iu desh të vlerësonte [REDAKTUAR] dhe intervistimi i dëshmitarëve bëri të nevojshme kërkimin e ndihmës juridike ndërkombëtare.

18. Për sa i përket argumentit të Mbrojtjes se ZPS-ja [REDAKTUAR], Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në deklaratat e [REDAKTUAR] të cilave u referohet Mbrojtja, [REDAKTUAR] ka folur për [REDAKTUAR] rrahjeve që pretendohet se i ishin bërë, por këto deklarata nuk tregojnë [REDAKTUAR].²⁵ Argumenti i Mbrojtjes se [REDAKTUAR] nuk është një ngjarje e paparashikueshme, është gjithashtu i pabazë. Në mungesë të treguesve konkretë, nuk mund të parashikohej domosdoshmërisht, mbi bazën e faktorëve të përgjithshëm, [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes rrëzohen.

19. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk është i bindur se Kërkesa cenon Mbrojtjen. Kjo për shkak se informacioni i dhënë nga dëshmitarët shërben për të konfirmuar informacionin [REDAKTUAR], i cili tashmë është nxjerrë për Mbrojtjen. Si rezultat, përfshirja e dëshmitarëve dhe e deklaratave të tyre nuk ndikon thelbësisht në pretendimet e ZPS-së ndaj të akuzuarit. Veç kësaj, ZPS-ja nuk po kërkon masa mbrojtëse për dëshmitarët.

20. Për të njëjtën arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gjykon se Mbrojtja ka nevojë për kohë shtesë për t'u përgatitur para se t'i kalojë Trupit Gjykues dosjen e çështjes gjyqësore. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson më tej se, siç u përmend, ZPS-ja tashmë e kishte bërë të ditur synimin e saj për ndërmarrjen

²⁴ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 14 prill 2022, publik, f. 276, rreshti 4 deri f. 287, rreshti 2; f. 300 rreshtat 8-9.

²⁵ [REDAKTUAR], f. 38-40; [REDAKTUAR], f. 23.

e veprimeve hetimore shtesë [REDAKTUAR] – konkretisht se do të kërkonte [REDAKTUAR], se do të duhej kohë për të gjetur vendndodhjen e tyre dhe për të siguruar ndihmën juridike ndërkombëtare dhe se dëshmitë shtesë do të kishin natyrë konfirmuese.²⁶ Rrjedhimisht, Mbrojta, e cila i kushtoi vëmendje parashtrimeve të ZPS-së,²⁷ ishte vënë tashmë në dijeni për veprimet hetimore shtesë të ZPS-së dhe për kërkesën që do të dorëzohej në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, kalendari procedural në lidhje me kalimin e çështjes në fjalë është ndryshuar së fundmi, në mënyrë që, ndër të tjera, t'i japë kohë shtesë Mbrojtjes për t'u përgatitur.²⁸ Për rrjedhojë, argumenti i Mbrojtjes nuk duhet të merret parasysh.

21. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon ZPS-në: (i) të nxjerrë për Mbrojtjen transkriptet e intervistave të saj me dëshmitarët në anglisht, së bashku me përkthimet e tyre në shqip; dhe (ii) të ndryshojë Listën e Dëshmitarëve dhe Listën e Provave Materiale të saj, duke përfshirë në to dëshmitarët dhe deklaratat e tyre përkatëse.

²⁶ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, konfidencial, f. 176 rreshti 17 deri f. 177 rreshti 10.

²⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 14 janar 2022, konfidencial, f. 177 rreshtat 13-20.

²⁸ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 14 prill 2022, publik, f. 298 rreshti 13 deri f. 300 rreshti 10.

VI. VENDIM

22. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën;
- (b) **AUTORIZON** ZPS-në të nxjerrë për Mbrojtjen transkriptet e intervistave të saj me W04276-ën, W04880-on, W04881-shin dhe W04882-shin në anglisht, së bashku me përkthimet e tyre në shqip, dhe të ndryshojë Listën e Dëshmitarëve dhe Listën e Provave Materiale të saj, duke përfshirë në to W04276-ën, W04880-on, W04881-shin dhe W04882-shin dhe deklaratat e tyre përkatëse;
- (c) **REFUZON** masën ndreqëse të specifikuar në Përgjigje; dhe
- (d) **URDHËRON** Mbrojtjen dhe ZPS-në të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të përkatësisht Përgjigjes dhe Kundërpërgjigjes, jo më vonë se të **premtën, 3 qershor 2022.**

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 30 maj 2022

Në Hagë, Holandë.